

VENDIM
Nr.33, datë 16.1.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË MJEDISEVE TË ISH-INSTITUTIT TË MJEDISIT
DHE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA OST SHA-JA MINISTRISË SË
DREJTËSISË, TË MJEDISEVE TË DISPEÇERISË QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së ndërtesës dhe të mjediseve të ish-Institutit të Mjedisit, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, të paraqitura në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., për nevojat e saj.

2. Transferimin e Albbakër sh.a.-së dhe Albkrom sh.a.-së, nga ndërtesa e ish-Institutit të Mjedisit dhe sistemimin në mjedise pune, të cilat do t’u vihen në dispozicion nga KESH sh.a.

3. Transferimi fizik dhe sistemimi, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, duhet të përfundojnë brenda një muaji nga hyrja në fuqi e vendimit.



4. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të ndërtesës, ku aktualisht ndodhet dispeçeria qendrore, e cila është në administrim të OST sh.a.-së, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, të paraqitura në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u vënë në dispozicion të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

5. Transferimi fizik, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të realizohet sapo të jetë ndërtuar dispeçeria e re qendrore e OST sh.a.-së.


6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



stojce



shiojce 2

1980